



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Strategjia e Kolegjit Biznesi për ndërkombëtarizim në periudhën 2020-2025

Në përmbushje të misionit të tij, Kolegji Biznesi, rëndësi të madhe i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke nxitur bashkëpunimin me universitete dhe partnerë të tjerë kudo në botë.

Qasja ndërkombëtare e Kolegjit përfshin dhe harmonizon aspekte të ndryshme të jetës universitare: mësimdhënien, kërkimin-shkencor dhe administrimin. Në këtë drejtim, Kolegji është i përkushtuar për t'i dhënë një përmasë dhe prani ndërkombëtare kërkimit që zhvillohet në Kolegj, botimeve që realizohen nga Kolegji dhe nga stafi akademik brenda dhe jashtë përmes kërkimeve shkencore, shkëmbimit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ me universitete partnere, si dhe krijimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Synimi strategjik - Synimi strategjik i Kolegjit Biznesi është zhvillimi dhe përmirësimi i të gjitha formave të bashkëpunimit ndërkombëtar, në funksion të mobilitetit të studentëve dhe stafit, duke vazhduar me programe studimi të përbashkëta të të gjitha niveleve (bachelor dhe master), kërkimeve shkencore dhe përfshirja në programet dhe projektet europiane.

Bashkëpunimi ndërkombëtar- Në këtë strategji, të përshtatur në rregulloret e reja të akreditimit dhe procedurave të vetëvlerësimit, iu dha një vend me rëndësi bashkëpunimit ndërkombëtar si fushë me interes të veçantë në zhvillimin dhe afirmimin e universitetit. Kolegji Biznesi nëpërmjet Strategjisë deri në vitin 2025, synon aplikimin e Politikës Arsimore Evropiane të përpunuar në pjesën e Procesit të Bolonjës dhe shpreh gatishmëri për tu bërë ndryshimet që të çojnë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë - EHEA.

Institucionet arsimore bashkëpunuese dhe lëvizshmëria- Kolegji Biznesi ka nënshkruar marrëveshje bilaterale të bashkëpunimit ndërkombëtar me universitete të huaja, që rregullojnë shkëmbimet e studentëve, mësimdhënësve dhe stafit administrativ. Marrëveshjet bilaterale janë baza për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale të Erasmus dhe në këtë drejtim Kolegji vetëm ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi dhe me partnerët konkuron në projektet Erasmus..

Lëvizshmëria e studentëve, mësimdhënësve dhe stafit administrativ në Kolegjin Biznesi janë aktivitete të vijueshme dhe në vazhdimësi do të rriten dhe zhvillohen konform rritjes së bashkëpunimeve me institucionet tjera arsimore jashtë vendit. Kolegji promovon dhe shtyt studentët të kyqen në procesin dhe programet e mobilitetit me qëllim të përfitimit të njohurive dhe përvojave të ofruara nga programe të tilla.

Përfitimet nga lëvizshmëria- Kolegji do të motivojë dhe informojë studentët dhe mësimdhënësit për përfitimet e lëvizshmërisë së jashtme, sepse lëvizshmëria është një tregues i rëndësishëm i cilësisë së individit dhe Kolegjit. Në përgjithësi pranohet që cilësia në të gjitha nivelet, në një vend tërheqës të Kolegjit, është elementi më i rëndësishëm i lëvizshmërisë hyrëse dhe duhet të zgjojë interesin ndërkombëtar në këtë pikë.

Njohja e periudhave të mobiliteteve Shkëmbimi dhe lëvizshmëria e mësimdhënësve dhe studentëve fillon edhe para se të bëhen nënshkrimet e marrëveshjeve. Në këtë drejtim Kolegji është fleksibil dhe bashkëpunues për interesin individual për periudhën e studimit të kaluar në Kolegj. Planifikohet që të themelohet zyra për njohjen e periudhës akademike ndërkombëtare të studimit.

Zhvillimi i programeve të përbashkëta me partnerët e Kolegjit- Puna për zhvillimin e disa programeve të përbashkëta është në zhvillim e sipër. Përvoja e mëparshme na tregon që programet e reja zbatohen nëse janë krijuar kushtet formale dhe financiare. Pritet që bashkëpunimi më i mirë të arrihet me vendet e rajonit, sepse deri tani ishte shumë më intensiv. Kolegji do të punojë për fillimin e programeve të reja mësimore nga niveli bachelor dhe masterit në vendet e rajonit përmes projekteve me partnerët Erasmus në mënyrë që të ndërtojë thelbin mësimor në vendet më pak të zhvilluara në mënyrë që ata të bëhen të pavarur në të ardhmen. Resurset humane në bashkëpunim ndërkombëtar Procesi i ndërkombëtarizimit të Kolegjit aktualisht është në zhvillim e sipër dhe në faza të ndryshme. Në të ardhmen, ne do të përpiqemi të arrijmë realizimin e ekuilibruar të lëvizshmërisë në të dy nivelet e studimeve. Supozohet se do të duhen disa vite derisa këto marrëdhënie të vendosen në ekuilibër. Duke pasur parasysh disponueshmërinë aktuale të personelit që punon me programet e shkëmbimit ndërkombëtar, konsideratë parësore do t'i kushtohet shkëmbimit të studentëve. Shkëmbimi më intensiv i mësimdhënësve dhe stafit administrativ mund të realizohet vetëm kur personeli i Zyrës për Bashkëpunim dhe Partneritet Ndërkombëtar është rritur. Deri atëherë, iniciativa individuale e lëvizjes së stafit mësimor dhe administrativ do të inkurajohet. Organizatat studentore duhet të përfshihen më shumë në procesin e ndërkombëtarizimit - për shembull në organizimin e ditëve të Mirëseardhjes për studentë të huaj, aktivitete sportive me universitete të tjera etj.



KLMSH i Kolegjit BIZNESI

Kryetari

/Prof dr Shyqeri Kabashi/